



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:162812
Datë: 04.12.2024
Numri i dokumentit: 06546221

C.nr.404/2017

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Feim Bytyqi, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të paditësit K.Sh nga Rahoveci të cilin me autorizim e përfaqëson Av.M.Bnga Rahoveci, kundër të paditurit D.Sh nga Rahoveci, me objekt kontesti padi për shkak të shkëputjes së kontratës mbi mbajten e përjetshme, vlera e kontestit 1,000.00 €uro, me datë 04.12.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET së është tërhequr padia me numër C.nr.404/2017, e paditësit K.Sh nga Rahoveci, kundër të paditurit D.Sh nga Rahoveci, lidhur me çështjen e shkëputjes së kontratës mbi mbajten e përjetshme.

A r s y e t i m

Paditësi I.Q.Sh, nëpërmjet të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate me dt.22.05.2017 ka parashtruar padi kundër të paditurit D.Sh nga Rahoveci, për shkak të shkëputjes së kontratës mbi mbajten e përjetshme.

Në bazë të padisë së paditësit, gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor për datë 02.12.2024.

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datës 01.11.2024 e ka njoftuar gjykatën se e bën tërheqjen e padisë së ushtruar me datë 22.05.2017, pasi që paditësi nuk është i interesuar që të vazhdojë procedurën gjyqësore sepse është i njëjti është në bisedime me të paditurin që kontestin lëndor ta zgjidh me marrëveshje, andaj në bazë të kërkesës së paditësit, i autorizuari i tij me anë të kësaj parashtrëse e tërheqë padinë.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.404/2017, datë 04.12.2024

B. Profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Feim Bytyqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 261.4 të LPK-së.